



Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-33858/24

Klinë, me 10.10.2024

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e bujqësisë me mekanizëm.

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë- Komuna e Klinës – Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të përkrahjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë, bën :

THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin :

1. Furnizim me frezë për traktor;
2. Furnizim me shpërndarëse të plehut për traktor.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të kostos së mekanizmit të lartpërmendur, ndërsa fermeri me 30 %; dhe
- Dhënie e këshillave profesionale, përmes eksperteve të saj.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Klinës;
2. Të posedojë tokë të punueshme;
3. Të posedon traktor;
4. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e mekanizmit;
5. Fermeri dhe anëtarët e ngushtë të familjes nuk mund të jetë përfitues i më shumë se një projekti brenda vitit;
6. Fermerët dhe anëtarët e ngushtë të familjes që kanë qenë përfitues të projekteve të komunës nga viti i kaluar nuk mund të përfitojnë nga projektet e komunës të këtij viti.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa (aplikacioni) e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës;
2. Kopja e letërnjoftimi e aplikuesit;
3. Numri identifikues i fermerit (NIF-it);
4. Certifikata e vendbanimit;
5. Certifikata e bashkësisë familjare.

Afati i aplikimit, është nga data **10.10.2024** deri më **24.10.2024**. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Vërejtje: Fermerët kanë të drejtë aplikimi vetëm në njërën nga projektet e lartcekura.

